



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 8.3.2023

Nr: 107

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARTISË POLITIKE “PARTIA BASHKIMI DEMOKRAT SHQIPTAR”, PËR  
REGJISTRIMIN SI SUBJEKT ZGJEDHOR PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË  
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 8.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim kërkesën me nr. 670 Prot., datë 7.2.2023, me:

**Kërkues:** Partia politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri

**Objekti:** Regjistrimi i partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

**Baza ligjore:** Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

**V Ë R E J:**

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

“Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, nëpërmjet kryetarit të saj z. Ylber Valteri, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023, administruar.

Bashkëlidhur kërkesës është paraqitur dokumentacioni vijues:

Data: 8.3.2023 Nr: 107  
Ora: 11:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, për regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

- a) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.01.2023, nëpërmjet të cilit vërtetohet se “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me iniciale “PBD”, me Kryetar z. Ylber Valteri rezulton e regjistruar në dokumentacionin e kësaj Zyre;
- b) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- c) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni si më sipër, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me shkronja nistore “PBD”, me adresë Rruga “Mine Peza”, ish Komiteti i Shkencës dhe Teknikës, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Ylber Valteri, me adresë, Rruga “Vaçe Zela”, nr. 48, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është zj. Irena Valteri me adresë Rruga “Vaçe Zela”, nr. 48, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Ylli Subashi, me adresë, Rruga “Ferit Xhajko” pranë ish restorant Durrësit, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkesa e paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, respekton afatin kohor të parashikuar në pikën 1 të nenit 64, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Dokumentacioni bashkëshoqërues kërkesës, i paraqitur nga “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, është në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 64, pika 2 dhe 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1 shkronja “n”, e 2, nenin 64 pika 2 dhe nenin 92 /2 pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

#### **VENDOSA:**

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar”, me kryetar z. Ylber Valteri, me shkronjat nistore “PBD”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**